



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E MJEDISIT
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT

A. Baza ligjore e institucioneve (Qëndrore dhe Lokale) mbi të cilat mbështetet implementimi i treguesve pan-europian të monitorimit në pyje.

1. Ligj Nr. 9385, datë 4.5.2005: “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor”.
2. Ligj Nr. 9791, datë 23.07.2007: “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9385 (Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor)” Neni 27/1 dhe neni 27/4
3. Ligj Nr. 9693, datë 19.3.2007: “Për fondin kullisor” i ndryshuar.
4. Ligj Nr. 9587, datë 20.7.2006: “Për mbrojtjen e biodiversitetit”.
5. Ligj Nr. 8906, datë 6.6.2002: “Për Zonat e Mbrojtura” i ndryshuar.
6. Ligj Nr. 10120, date 23.04,2009 “Për mbrojtjen e fondit të bimëve mjekësore, etervajore e tanifere natyrore”
7. Ligj Nr. 10 431, datë 09.06. 2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”.
8. Ligj Nr. 8752, datë 26.03.2001 “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”.
9. VKM nr.121 date 17.02.2011 “Për mënyrat e ushtrimit të funksioneve nga Drejtoria e administrimin dhe mbrojtjen e tokës ne Qark dhe zyrat e menaxhimit dhe te mbrojtjes se tokes ne komune”.
10. VKM Nr.1189, datë 18.11.2009 “Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisi”
11. VKM Nr.47 date 29.01.2014 “Për caktimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit e të Agjencive Rajonale të Mjedisit”
12. VKM Nr.46 date 29.01.2014 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave”
13. VKM Nr.58 13.02.2014 “Për miratimin e strukturës dhe organikës të Ministrisë së Mjedisit”
14. Programi Kombëtar i Monitorimit për vitin 2014; Treguesi: “Biodiversiteti në pyje”; “Shëndeti në pyje”; “Tokat pyjore”; “Treguesit Silvikulturorë”; “Madhësia e Fondit pyjor”.
15. Udhëzimi Nr 4 datë 12.09.2008 “Per mbajtjen e kadastres se fondit pyjor dhe kullisor”

B. Misioni i Drejtorisë së Pyjeve:

Zhvillon implementimin e kritereve dhe standarteve pan - evropiane të monitorimit të pyjeve, nxit studime e projekte për zhvillimin e qëndrueshëm e multifunksional të pyjeve në Shqipëri.

C. Fushat e veprimtarisë:

Në zbatim të ligjit Nr.10431, datë 6.09.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit" të nenit 19 "Mbrojtja e natyrës"; nenit 41 "Monitorimi i gjendjes së mjedisit"; nenit 45 "Qëllimi dhe funksionimi i sistemit të informacionit mjedisor dhe, nenit 60 mbi "Funksionet e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit" si dhe VKM, Nr 47, date 29.01.2014 "Për përcaktimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit" fushat e veprimtarisë së Drejtorisë Pyjeve janë përcaktuar sipas pikave:

h) Menaxhon sistemin e të dhënave për pyjet.

i) Përgatit dhe mbikqyr Inventarin Kombëtare të Pyjeve.

j) Zhvillon planet e menaxhimit të Pyjeve.

k) Monitoron pyjet në drejtim të zbatimit të detyrimeve kombëtare dhe ndërkombetare.

l) Siguron zhvillimin dhe transferimin e teknologjive në lidhje me pyjet.

D. Drejtoria e Pyjeve ofron:

1. Shërbimin e monitorimit të pyjeve
2. Shërbimin e projktimeve pyjore dhe kullosore
3. Shërbimin e studimeve dhe transferimit të teknologjive në fushën e pyjeve, ZM, kullotave dhe BMA-ve .
4. Shërbimin e konsulencave teknike në fushën e pyjeve, ZM, kullotave dhe BMA-ve
5. Shërbimin e menaxhimit të bazës të dhënave për treguesit e monitorimit,
6. Shërbimin e mbikqyrjes së inventarit kombëtar të pyjeve.
7. Shërbimin e mbikqyrjes së planeve të menaxhimit të pyjeve.